



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZE
NJËSIA E PROKURIMIT

Bulqize, më _____.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: Sistemim asfaltim i rruges se kufirit (nga fshati Viçisht , NjeAdm Gjorice deri ne fshtain Klenje, NJ.Adm Trebisht) bashkia Bulqize, loti 1

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45000000 - 7, Pune ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 95 000 000 (nentedhjetë e pesë milion) leke pa tvsh.. Vlera e parashikuar per vitin 2026 eshte 28 500 000(njezete e tete milion e peseqind mije) leke pa tvsh, per vitin 2027 eshte 38 000 000 (tridhjetë e tete milion) leke pa tvsh si dhe per vitin 2028 eshte 28 500 000(njezete e tete milion e peseqind mije) leke pa tvsh

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Bulqize**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç”

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim të deklarimit të xhiros vjetore gjatë për 3 viteve të fundit financiare (2023,2024,2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 /b e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.**

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 2.2.1 dhe pika 2.2.2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kanë detyrime të prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së.

¹

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Kriteri për piken 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar),

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjere të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anetar të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këto kushte. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- IV. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- V. Formular Vlerësimi nga Investitori*

- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- II. Situacionin përfundimtar të objektit*
- III. Faturat Tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore*
- IV. Aktin e Kolaudimit të objektit*

- c) Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin kontratën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit .

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij

kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojes realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave të sipërpermendura, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

AK ka kërkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*.

2.3.3 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P – 1B Punime gjurmimi në tokë;
- N.P - 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- N.P – 7A Ujesjellësa , gazjellësa , vajsjellësa , vepra kullimi e vaditje;
- N.P – 12A Punime te inxhinierise mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- N.S – 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore
- N.S – 18 C Punime topogjodezike

** Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

*** Ne rast bashkimi operatoresh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P – 1B Punime gjërmimi në tokë;

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjërmime në tokë (**konkretisht zerrat me numer analize: 3.110/b, 3.104/a, 3.104/b, 3.124/1a etj**) ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e infrastruktures rrugore (**konkretisht zerrat me numer analize 3.231/1, 3.229/2, 3.212/b, 3.164/1b etj, perfshire te gjithë proceset e punes sipas preventivit te objektit**) është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.P-4 ku bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

N.P - 7A Ujesjellësa , gazjellësa , vajsjellësa , vepra kullimi e vaditje;

Ne preventivin e punimeve te ketij objekti jane parashikuar edhe punime per ndertimin e veprave te artit + kanalizime , si tombino me tuba betoni , tuba metalike, tuba HDPE, kanal betoni, kanal i hapur natyral etj. **Konkretisht zerrat me numer analize: 3.365, 3.367, 3.369, 3.408, 3.164/1t etj**), te cilat shihen te nevojshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorine N.P 7.

□ N.P – 12A Punime te inxhinierise mjedisore

Ne preventivin e punimeve jane parashikur punime shpylleszimi qe lidhen ngushte me anen mjedisore , **konkretisht zerat me numer analize 3.2 dhe 3.3 etj**, si dhe pervec ketyre sasia e germimeve ne skarpatat e rruges qofte per mbushjen apo zgjerimin e trasese rrugore , jan ete konsiderueshme dhe nepermjet licences se nevojshme NP 12 duhet te sigurohet impakt sa me i ulet ne mjedis.

□ N.S – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje strukturash dhe germim shkambi (**konkretisht zerat me numer analize: 3.405, 3.405/1, 2.47/an etj**) ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

□ N.S – 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne me sinjalistika ne rruge (**konkretisht zerat me numer analize: 3.936, 3.955, 3.942/3, 3.933 etj**), te cilat shihen te nevojshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategoria N.S-6.

□ N.S – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne me barriera mbrojtese (**konkretisht zeri me numer analize: 3.185, 3.919 etj**), te cilat shihen te nevojshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategoria N.S-7.

□ N.S – 18 C Punime topogjodezike

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të konsiderueshme te natyrës topogjodezike, vecanerisht (**proceset e punes per germim mbushje te rruges, shtresat asfaltike, punimet e veprave te artit per ura, tombino, mure etj, sipas preventivit**)dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – **Kodi III.2.B - “Grumbullim, ruajtje dhe transport te mbetjeve inerte”**, referuar Vendim nr.538, datë 26.5.2009 për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa se Operatoret ekonomike pjesemarres duhet te jene te pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2. B është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V,

Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- 1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 2. Certifikatën SSH ISO 45001:2018** e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 3. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 4. Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.4 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 sipas zerave të punimeve të marra përparësi, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e sigurisë së trafikut rrugor. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **44 (dyzete e kater) punonjës** për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojces 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave duhet të dorëzojë dokumentacionin provues për pikat 1 dhe 2.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. **ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Raportit/Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **44 (dyzete e kater)** punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj duke iu referuar **dhe perlllogaritjes teknike të kryer nga specialisti i fushës** bashkangjitur tabela e perlllogaritjes për makineri, punëtor, sipas analizave teknike të manualit për çdo punimësh

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistet e fushës kanë bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **44 punonjes** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në kater elementet e strukturës së kostos (material, punëtor, makineri, transport).

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier ndertimi 1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinjer Gjeodet/Topograf/Markshajder 1 (nje)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (nje)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për inxhinieret e mesiperm.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, në varesi të vlerësimit preventiv të punimeve që ka marrë për sipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. “një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës kapacitetit teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. **Referuar preventivit të Punimeve** si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NP 1 , NP 4, NS 6 dhe NS 7 është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi dhe inxhinier gjeoteknik Ku është kërkuar NS 18, është e nevojshme prezenca e 1 (nje) Inxhinier

Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri. Per punimet e preventivit që lidhen me piken e licences NP 7 nevojitet inxhinieri hidroteknik.

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre stafin mbështetes (jo domosdoshmërisht drejtues Teknik ne licencen e shoqërisë) të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht

- 1(nje) Inxhinier ndertimi (profili infrastrukture-transport)
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Inxhinier mjedisi është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me licencen e kërkuar Kodi III.2.B - “Grumbullim, transportim, ruajtje, i mbetjeve inerte” dhe sikunder gjate punimeve kemi te bejme me germime masive ne skarpata, punime betoni etj, qe perfshihen tek inertet ose mbetjet e ngurta, nevojitet prezenca e nje **inxhinieri mjedisi** te pakten si staf mbështetes i cili garanton mbrojtjen dhe nje impakt sa me te ulet ne mjedis gjate punimeve te zbatimit , pasi zona ku do te realizohen punimet eshte shume e pyllezuar dhe me burime ujore te shumta.

Vendosja Inxhinier ndertimi (profili infrastrukture-transport) eshte vendosur referuar preventivit te Punimeve pasi shumica e zerave te punes lidhen drejtperdrejt me punimet ne rruge si psh shtresat asfaltike, sinjalistike rrugore etj

2.3.10. Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij personal te kualifikuar /certifikuar të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma/certificate përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave:

- Nje (1) punonjes “pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune ”, I cili duhet te jete I certifikuar “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune ” ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18.02.2010 “ Per sigurine dhe mbrojtjen ne pune” dhe VKM NR 312 date 05.05.2010, “Per Miratimin e Rregullores per Sigurine ne Kantjer.”

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, ***punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijës dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë.*** Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje punonjes te specializuar/ te kualifikuar dhe te figuroj nje listpagesat e shoqerise per 3 muajt te fundit. Si me poshte:

- a) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 4 (kater) **punonjes manovrator** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, leje drejtimi, deshmi e aftesise profesionale (te vlefshme)/ Patente Manovrimi nga DPSHTRR
- b) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 5 (pese) **punonjes shofer** per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune, leje drejtimi, deshmi e aftesise profesionale (te vleshme)
- c) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) **Automakinist** , per te cilet duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, leje drejtimi, deshmi e aftesise profesionale (te vlefshme)/ Patente Manovrimi nga DPSHTRR

Shenim: (Ne rastin kur punonjesit manovrator/shofer/automakinist jane te kontraktuar me kontrate pune (*respektivisht per mjetet e marra me qera*) nuk kerkohet te figurojne ne listpagesen e shoqerise)

- d) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) **Teknik ndertimi**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- e) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) **Teknik topograf**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- f) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) **Specialist ndertimi per punime ne rruge**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- g) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) **Betonues**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese
- h) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 3 (tre) **Karpentier** , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese
- i) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) **Elektricitist**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- j) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 2 (dy) **Hekurkthyes**, per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese
- k) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) **Murator** , per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- l) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 1 (nje) **Saldator** per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.
- m) OE ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 5 (pese) **Punonjes asfalti** per te cilin duhet te paraqese kontrate individuale pune te vlefshme, deshmia aftesie profesionale (te vleshme) ose diploma, leshuar nga institucionet perkatese.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per specialistet , emer/mbiemer, profil i punes, daten e kontratës individuale të punës, numrin e certifikates profesionale si dhe institucioni private ose shteterore qe e ka leshuar.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit manovrator shofer dhe automakinist , emer/mbiemer, profil i punes,

daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarohet se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit Teknik të punësuar staf Teknik (specialist, punetor) për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt,eshte kerkuar kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse/*certifikatë e arsimit profesional*) sipas ligjitNr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”

Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional.

2.3.12 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e konkretisht:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-20 Ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-12 Ton	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Kamioncina me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Kamion me vinc ose autovinç	Ne pronesi ose me qira	1 cope

•	Dumper me kapacitet mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Minidumper me kapacitet deri ne 6 ton	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Minifadrome me goma	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Grejder me goma	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Rrul ngjeshes hekur-gome per nenshtresat	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Rrul ngjeshes hekur-hekur per shtresat asfaltike	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Mini rrul per bankinat	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Eskavator me zinxhir	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Eskavator me zinxhir me çekic	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Minieskavator me goma	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Asfalto shtruese	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Autobitumatriçe	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Makineri per montim guardrail	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Makineri vijezi	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qira	3 cope
•	Betoniere 0.5 m3	Ne pronesi ose me qira	3 cope
•	Autobetoniere 5-10 m3	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autobetoniere 2-5 m3	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autopompe betoni	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Depozite uji mbi 5000 l	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Gazogjen	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Elektro/Moto Saldatriçe	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	1cope

•	Pajisje topogjeodezike (total station/GPS)	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Gjenerator/motogjenerator	Ne pronesi ose me qira	1cope
•	Linje inerte e pajisur me leje mjedisore	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	1 cope
•	Linje asfalti e pajisur me leje mjedisore	Ne pronesi ose me qira ose kontrate furnizimi	1 cope

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 44 copë*
- Kutitë e ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 3 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5 litra – *jo më pak se 3 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 5 copë*
- Jelek fosforeshent -*jo më pak se 44 cope*

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për punëtorët e mesiperm.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknik

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, ***Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.***

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, nga ana e specialistit të fushës është përcaktuar duke marrë në konsideratë zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë tipologjinë dhe natyrën e punimeve. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetëve të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	ARGUMENTIMI
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Nevojiten për transportin e materialeve të rruges, si cakull stabilizant asfalt deri në kantierin e ndërtimit etj
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-20 Ton	Nevojiten për transportin e materialeve të nxjerra nga prishjet dhe germimet e dheut
•	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-12 Ton	Nevojiten për transportin e materialeve të nxjerra nga prishjet dhe germimet e dheut

•	Kamioncina me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	Nevojiten per transportin e materialeve te te ndryshme ne kantierin e ndertimit
•	Kamion me vinc ose autovinç	Nevojiten per levizjen e materialeve me peshe te madhe si shtyllat elektrike, tombino betony, hekur betoni periodik
•	Dumper me kapacitet mbi 20 ton	Nevojiten per transportin e materialeve te rruges , si cakull stabilizant brenda ne kantierin e ndertimit etj
•	Minidumper me kapacitet deri ne 6 ton	Nevojiten per transportin e materialeve te rruges , si cakull stabilizant brenda ne kantierin e ndertimit etj
•	Fadrome me goma	Nevojiten per shtrimin e cakullit dhe mbushjen pas mureve
•	Minifadrome me goma	Nevojiten per shtrimin e cakullit dhe mbushjen pas mureve
•	Grejder me goma	Nevojitet per shperndarjen e cakullit dhe stabilizantit pergjate trupit te rruges
•	Rrul ngjeshes hekur-gome per nenshtresat	Nevojitet per ngjeshjen e cakullit dhe stabilizantit pergjate trupit te rruges
•	Rrul ngjeshes hekur-hekur per shtresat asfaltike	Nevojitet per ngjeshjen e shtresave asfaltike (binder dhe tapet)
•	Mini rrul per bankinat	Nevojitet per ngjeshjen e stabilizantit te bankinave
•	Eskavator me goma	Nevojitet per germimet e kanaleve ne zonat ku rruga ka taban dhe nuk duhet te demtohet
•	Eskavator me zinxhir	Nevojitet per germimet massive ne rruge dhe skarpatat e saj
•	Eskavator me zinxhir me çekiq	Nevojitet per germimet ne skarpatat e rruges ne prani guresh shkembinjsh
•	Minieskavator me goma	Nevojitet per germimet ne kanalet e tubave dhe tombinove
•	Asfalto shtruese	Nevojitet per shtrimin e shtresave asfaltike (blinder + tapet)

•	Autobitumatriçe	Nevojitet per shtrimin e prajmerit para shtresave asfaltike
•	Makineri per montim guardrail	Nevojitet per vendosjen e elementeve sigurise rrugore
•	Makineri vijeziimi	Nevojitet per vijezimimin e rrugeve ne ted y anet
•	Vibrator betoni	Nevojitet per vibrimin e betonit per te arritur rezistence maksimale
•	Betoniere 0.5 m3	Nevojitet per te realizuar betonet te markes 150 ose 200 per kanale shtresa etj
•	Autobetoniere 5-10 m3	Nevojitet per te realizuar betonet e mureve me gjatesi te madhe, te markes 300 (volume te shumta betoni) etj
•	Autobetoniere 2-5 m3	Nevojitet per te realizuar betonet e mureve me gjatesi te vogel, kanale (volume te pakta betoni) etj
•	Autopompe betoni	Nevojitet per hedhjen e betonit nga autobetonieria 10 m3
•	Autobot uji	Nevojitet per sperkatjen e shtresave rrugore qe te arrin ngjeshjen maksimale
•	Depozite uji mbi 5000 l	Nevojitet ne kantier per realizimin e betoneve sipas preventivit
•	Gazogjen	Nevojiten per vendosjen e tubavee metalike
•	Elektro/Moto Saldatriçe	Nevojiten per vendosjen e tubavee metalike
•	Matrapik	Nevojitet per prishjen e strukturave prej guri ose betoni
•	Pajisje topogjeodezike (total station/GPS)	Nevojitet per matjen e kuotave topografike te germimeve, shtresave mbushese, asfalteve etj
•	Gjenerator/motogjenerator	Nevojitet per prezencen e elektricitetit ne kantierin e ndertimit

•	Linje inerte e pajisur me leje mjedisore	Nevojitet per sigurimin e materialeve te rruges cakull, stabilizant etj dhe inerteve per realizimin e betoneve te ndryshme
•	Linje asfalti e pajisur me leje mjedisore	Nevojitet per sigurimin e materialeve qe lidhen me shtresat asfaltike

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.